



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/57


Datë: 17.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 korrik 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti në Fushën e Turizmit.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

## KONCEPT DOKUMENTI NË FUSHËN E TURIZMIT

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor.....</b>	<b>4</b>
<b>3. Synimet dhe objektivat.....</b>	<b>11</b>
<b>4. Opsionet.....</b>	<b>13</b>
<b>5. (Përmbledhja e opsioneve) .....</b>	<b>17</b>
<b>6. Analiza e opsioneve .....</b>	<b>19</b>
<b>7. Konsultimet.....</b>	<b>24</b>
<b>8. Krahasimi i opsioneve (shqyrtimi i pasojave të çdo opsioni).....</b>	<b>27</b>
<b>9. Rekomandimet.....</b>	<b>29</b>
<b>10. Komunikimi.....</b>	<b>30</b>

## KAPITULLI 1: HYRJE

Koncept Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzimin për përgatitjen e Koncept Dokumenteve dhe Memon shpjeguese nr. 074/2012 të datës 19 mars 2012 dhe në përputhje me Rregullat dhe procedurat e Qeverisë. Koncept dokumenti është përgatitur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me mbështetjen nga TAIEX. Ky koncept dokument është paraparë të hartohet sipas planit të punës së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2018.

Turizmi në Kosovë është mesatarisht i zhvilluar, edhe pse ka shënuar përmirësime të shpejta në vitet e fundit, por ende është i organizuar në mënyrë joefikase, pa rregulla ligjore të zbatueshme, pa objektiva strategjike dhe pa politika koherente të turizmit, si dhe i organizuar në një nivel nën-optimal në administrim dhe biznes të turizmit. Kjo situatë kërkon një qasje dhe zgjidhje strategjike dhe sistematike për të mundësuar zhvillimin e biznesit të turizmit në baza konkurruese si dhe për t'i komunikuar tregut se vendi stimulon cilësinë, i mbron të drejtat e konsumatorit dhe është i hapur për bashkëpunim ndërkombëtar.

Turizmi është duke funksionuar në mjedisin pothuajse më konkurrues, të tregut të lirë. Turizmi në shumicën e vendeve fqinje konsiderohet si sektor prioritar dhe është i rregulluar me akte ligjore dhe instrumente politikash në përputhje me BE. Turizmi në Kosovë po zhvillohet në baza të tregut të lirë, me iniciativa sipërmarrëse dhe rreziqe biznesi. Por, përkundër kësaj, turizmi është një aktivitet që gjithashtu ka nevojë për intervenime, politika dhe veprime publike.

Arsyet kryesore për domosdoshmërinë e ndërhyrjes me politika në turizëm në Kosovë janë:

- Turizmi kryesisht përdor burimet natyrore dhe kulturore, ato më të vlefshmet dhe të rralla prandaj kjo kërkon përdorim dhe menaxhim të qëndrueshëm
- Turizmi po zhvillohet në fusha/zona së bashku me përdoruesit e tjerë (ekonomik, social) të hapësirës, si dhe në kontakt të ngushtë me banorët, dhe si i tillë kërkon planifikimbalancues në përdorimin e hapësirës
- Turisti është konsumuesi i fundit në ekonominë turistike prandaj kërkohet mbrojtja e konsumatorëve
- Ekonomia e turizmit përbëhet kryesisht nga NVM-të të cilat kanë nevojë për një mjedis dhe trajtim të posaçëm pozitiv të biznesit për zhvillim efikas
- Turizmi është një veprimtari shumë sektoriale (bujqësi, industri, kulturë, sport, planifikim hapësinor, infrastrukturë, etj.) i cili kërkon koordinim dhe planifikim të politikave
- Zhvillimi dhe promovimi i brendit/imazhit të turizmit është një kombinim i burimeve natyrore dhe kulturore, hotelerisë por edhe të politikës, rezultateve ekonomike, sportit, kulturës dhe nivelit të jetesës prandaj kjo kërkon mbështetje publike

- Turizmi në Kosovë ka arritur në stadin e zhvillimit që kërkon një strukturë bazike ligjore dhe organizative si dhe rregulla për një zhvillim efikas të mëtjshëm
- Organizimi institucional i turizmit në Kosovë ka ngecur në krahasim me gjitha vendet fqinje
- Zgjidhjet ligjore për turizmin në Kosovë duhet të ndjekin direktivat, udhëzimet dhe praktikatat e mira në BE.

Qeveria e Kosovës e adreson turizmin në dokumentet e mëposhtme:

- Programi i Qeverisë së Kosovës 2017-2021
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA)
- Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2018
- Programi për reforma ekonomike 2018-2020

## **KAPITULLI 2: PËRSHKRIMI DHE PËRKUFIZIMI I ÇËSHTJES / PROBLEMIT KRYESOR**

Zhvillimi i turizmit është i kufizuar për shkak të faktit se deri tani nuk ka pasur qasje gjithë përfshirëse dhe nuk ka qenë një sektor i rëndësishëm për zhvillim ekonomik. Derisa në 5-7 vitet e fundit, turizmi në vendet fqinje është zhvilluar me mbështetje të madhe nga shteti dhe politikatat e tij. Shumë prej këtyre vendeve është dashur të zhvillonin strukturën organizative të turizmit, mjedisin ligjor dhe politikën e turizmit pa pasur ndonjë histori dhe traditë të madhe të turizmit (për shembull: Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria). Kosova është vendi i fundit të cilit do t'i duhet të fus sistemin e njohur ndërkombëtarisht të qeverisjes së turizmit dhe mbështetjes së politikave në mënyrë që të përfitojë nga benefitet e zhvillimit të turizmit: kontributi në rritjen ekonomike, punësimin, zhvillimin rajonal etj.

Spektori i akomodimit turistik me hotele, motele, bujtina si dhe të ngjashme, është rritur vazhdimisht sa i përket numrit të objekteve dhe akomodimeve (shtretërve). Për të njëjtit, nuk ka pasur standarde të qarta minimale të detyrueshme në lidhje me madhësinë, pajisjet dhe shërbimet të cilat do t'u tregonin atyre në mënyrë të qartë se hotel të çfarë niveli cilësie do të ndërtonin. Kjo ka ndikuar edhe në informimin e turistëve në lidhje me atë se çfarë cilësie të hoteleve mund të presin në Kosovë.

Në anën tjetër, operatorët turistik, agjencitë e udhëtimeve si dhe ciceronët turistik operojnë pa ndonjë kusht themelor që do t'u kërkonte atyre të ofrojnë garanci për konsumatorët/turistët në rast të aksidenteve, paaftësisë pagueve (insolvencës) së kompanive, ofrimit të pakove apo shërbimeve të cilat nuk përputhen me atë që është promovuar apo premtuar, etj.

Zhvillimi i turizmit, veçanërisht i qendrave turistike, është gjithashtu i kufizuar për shkak të faktit që nuk ekzistojnë zonat e përkufizuara turistike dhe nuk ka ndonjë strategji për zhvillimin e turizmit.

Kosovës gjithashtu i mungon ndërtimi i imazhit të saj turistik në kuadër të tregjeve ndërkombëtare dhe marketingut efektiv. Nuk organizohet promovimi dhe shërbimet për informim të vizitorëve. Në ditët e sotme, kur ka konkurrencë shumë të madhe në tregjet e turizmit, Kosova nuk ka mundur të promovojë potencialet turistike dhe të sjellë turistë ndërkombëtarë dhe si e tillë nuk është konkurruese as në rajon.

Projekti IBF, në MTI, për implementimin e Direktivës Evropiane të shërbimeve, në fazën e shqyrtimit të legjislacionit përkatës të shërbimeve në Kosovë, **gjatë shqyrtimit të Ligjit për Turizmin** janë evidentuar vetëm 2 shërbime turistike në Kosovë që janë të mbuluara pjesërisht me legjislacion, ndërsa janë evidentuar se ekzistojnë gjithsej rreth 24 shërbime turistike që operojnë në Kosovë pa ndonjë kriter dhe rregullim ligjor **dhe të cilat duhet të rregullohen me legjislacion që jemi në harmoni me direktivat e BE-se.**

Në sektorin e turizmit nuk kemi një cilësi të mirë e produkteve dhe shërbimeve turistike dhe pozita e tyre nuk është konkurruese në treg.

Zhvillimi i turizmit dhe efektet e turizmit ndjehen posaçërisht në disa destinacione rreth qyteteve të Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Mitrovicës, Prishtinës dhe të ngjashme që vizitohen më shumë nga turistët.

Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni numrin e turistëve që qëndruan në hotele në Kosovë, numrin e hoteleve dhe restoranteve si dhe numrin e të punësuarve në hotele dhe restorante për periudhën 2012-2016.

**Tabela 1: Ardhjet, numri i hoteleve dhe restoranteve dhe i të punësuarve në 2012 -2016<sup>1</sup>**

Madhësia dhe kohëzgjatja e problemit					
	2012	2013	2014	2015	2016
Nr. i turistëve	98.763/	95.454/	102.790/	139.438/	129.289/
/ Nr. i hoteleve dhe restoranteve /	955/	911/	1.034/	1.018/	1.017/
Nr. i të punësuarve	14.300	18.000	19.700	19.800	21.300

<sup>1</sup> Burimi: ASK

Me të dhënat në tabelën e mësipërme paraqesim madhësinë e flukseve të turizmit dhe bizneseve turistike në Kosovë, megjithatë këto të dhëna statistikore zyrtare nuk paraqesin dimensionin e plotë të turizmit në Kosovë. Agjencia e Statistikave të Kosovës bëri një hulumtim të të gjitha kapaciteteve akomoduese në Kosovë dhe nga hulumtimi dolën rezultatet që në Kosovë janë 194 hotele (në krahasim me 121 që raportojnë nr. e turistëve) me 7.066 shtretër (në krahasim me 4.439 që raportohen) – ekzistojnë 60% më shumë hapësira me shtretër që kanë akomoduar turistë e që nuk janë përfshirë në statistikat zyrtare.

Agjencia e Statistikave të Kosovës regjistron në bazë të të dhënave të policisë kufitare edhe hyrjet e vizitorëve ndërkombëtarë në Kosovë. Në periudhën tremujore nga muaji korrik – shtator 2017, kishte 352.464 persona me pasaporta të huaja që kanë hyrë në Kosovë për arsye personale (duke përjashtuar punën, tranzitin dhe të ngjashme). Kjo tregon që vëllimi i turizmit në Kosovë është shumë më i lartë se sa që është regjistruar dhe prezantuar zyrtarisht.

Të gjitha informacionet e mësipërme tregojnë që dimensionin e turizmit është duke u rritur shpejtë, që vëllimi i tij është shumë më i lartë se ai i regjistruar dhe që turizmi duhet të rishqyrtohet në mënyrë sistematike, të organizohet në masë të plotë në bazë të standardeve të krahasueshme ndërkombëtare me rregullim efikas ligjor dhe intervenime të politikave.

**Tabela 2: Shpenzimet aktuale në Kosovë**

Kategoria e shpenzimeve	Viti paraprak	Buxheti për këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Paga dhe mëditje	98,837.76	117,231.00	118,170.00
Mallra dhe sherbime	50,300.00	50,300.00	50,300.00
Buxheti tjetër (listo çdo lloj)			
Financimi nga donatorët			
<b>Gjithsej</b>	<b>149,137.76</b>	<b>167,231.00</b>	<b>168,470.00</b>

#### **Politikat aktuale në fushën e turizmit**

Divizioni i Turizmit (DT) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për hartimin e politikave për turizmin. DT gjithashtu mbështetet nga departamentet tjera të Ministrisë, si për shembull Departamenti Ligjor, ai për Mbrojtjen e Konsumatorit, Prokurimin dhe agjencitë si

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA), inspeksioni i tregut i Agjencisë së Kosovës për Standardizim.

Përveç MTI-së, institucionet tjera shtetërore që nderlidhen me turizmin përfshijnë:

MKRS, MMPH, MBPZHR, MASHKT, Drejtoritë Komunale për Zhvillimin Ekonomik apo Drejtoritë për Turizëm (vetëm në disa komuna).

Divizioni i Turizmit aktualisht fokusohet në fushat e punës si në vijim:

- Performanca e turizmit dhe ndikimet me planifikimin e zhvillimit të turizmit, produktet e turizmit dhe matja statistikore/ndjekja e rezultateve të zhvillimit të turizmit
- Përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të turizmit me promovimin e klasifikimit të hoteleve, mbështetjen për mikro-bizneset në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve
- Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare për mbështetjen e turizmit të Kosovës
- Mbështetja për promovimin e turizmit të Kosovës
- Bashkëpunimi me ministritë tjera të linjës dhe komunat e rëndësishme në aspektin e turizmit
- Mbështetja për funksionimin e Këshillit të Turizmit të Kosovës
- Bashkëpunimi dhe mbështetja për bizneset turistike – hotelet, restorantet dhe operatorët turistik/agjencitë e udhëtimit
- Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare donatore
- Bashkëpunimi ndërkombëtar.

#### **Ligjet dhe aktet normative në fushën e turizmit**

1. Ligji nr. 04/L-176 për Turizmin;

1.1. Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 19 /2013 për Rregullimin dhe Zhvillimin e Sistemit të Vlerësimit të Akomodimit;

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim përcaktimin e procedurave për klasifikimin dhe kategorizimin e objekteve hoteliere si dhe punën e komisionit për klasifikim dhe kategorizim të objekteve hoteliere.

1.2. Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 07/2014 për Regjistrin e Kategorizimeve, Regjistrimin Vullnetar dhe Revokimin e Regjistrimit;

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet përmbajtja e regjistrit të kategorizimit, procedura e regjistrimit vullnetar dhe revokimit të regjistrimit të veprimtarive turistike.

1.3. Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 10/2014 mbi Përmbajtjen e Katalogut të Akomodimit;



Ky udhëzim administrativ rregullon katalogun e akomodimit me të cilin përcaktohet përmbajtja e tij.

2. Ligji nr. 03/L-027 për Taksën e Akomodimit në Objekte Hoteliere e Turistike nga viti 2008;

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka nxjerrë gjithashtu Rregulloren për Themelimin dhe Funksionimin e Këshillit të Turizmit të Kosovës (Rregullorja Nr. 1/2013).

Efekte të drejtpërdrejta ose të tërthorta në turizëm kanë edhe ligjet në vijim:

1. Ligji nr. 05/L-130 për Shërbimet

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që mundësojnë të drejtën e themelimit dhe të ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Kosovë, duke garantuar njëkohësisht siguri dhe cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre. Në kuadër të shërbimeve të cilat i rregullon ky ligj, sektori i turizmit bënë pjesë në masë të konsiderueshme me shërbime që kanë të bëjnë me fushën e turizmit.

2. Ligji nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit

Me këtë ligj rregullohen dhe mbrohen të drejtat themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave tjera në tregun e lirë si dhe detyrimet e shitësit, prodhuesit dhe furnizuesit.

Turisti i jashtëm apo i brendshëm gjatë blerjes së shërbimeve turistike llogaritet të jetë edhe konsumator njëherit pasi që ligji për mbrojtjen e konsumatorit mbron edhe shërbimet.

3. Ligji nr. 05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës

Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqytjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike.

Sektori i turizmit në këtë ligj konsiderohet si sektor për investime strategjike dhe duke qenë se është përfshirë në kuadër të fushave të veprimit.

4. Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimi kulturore

Objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, të krijuara gjatë shekujve, gjithashtu mjetet legale dhe teknike për inventarizim, dokumentim, selektimi mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të këtyre thesareve në pajtim me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje. Vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore i ndihmon turizmit për zgjerimin e ofertës turistike në turizmin kulturor. Ky ligj ka për qëllim edhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

5. Ligji nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut

Me këtë ligj përcaktohen parimet, organizimi, kompetencat dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në territorin e Republikës së Kosovës. Në këtë ligj edhe pse në kompetencat e Inspektoratit të tregut parashihet Veprimtaria hoteliere e turistike (neni 9 parag.1.7) neni 33 Dispozitat ndëshkuese nuk parashihet asnjë gjë lidhur me këtë veprimtari.

6. Ligji Nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese në treg, ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave si dhe rregullimin e regjimit të ngasjes dhe pushimit. Zhvillimi i transportit rrugor kontribuon në zhvillimin e turizmit sidomos me vendet fqinje dhe vendet e rajonit në qasjen më të lehtë të turistëve në Kosovë.


7. Ligji Nr. 03/L-051 për aviacionin civil

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha veprimtaritë në fushën aviacionit civil të cilat zhvillohen brenda territorit dhe hapësirës ajrore të Kosovës. Ky ligj i mundëson zhvillimin e mirë të aviacionit civil i cili i ndihmon lëvizjen e sigurtë me transportin ajror të turistëve.

### **Përvojat në shtet tjera**

Turizmi në Kosovë menaxhohet dhe mbikëqyret nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nëpërmjet një Divizioni nën Departamentin e Industrisë. Niveli administrativ i turizmit është i përfaqësuar shumë pak në këtë ministri, krahasuar me përgjegjësinë dhe rëndësinë që ka sektori i turizmit për zhvillimin dhe kontributin në ekonominë e vendit. Për më tepër, Kosova nuk ka një përfaqësim më të mirë të turizmit administrativ dhe krahasuar me vendet e tjera fqinje, nuk ka themeluar Departamentin e Turizmit, Ministrinë e Turizmit dhe Organizatën apo Agjencinë Kombëtare të Turizmit (OKT / AKT). Në të gjitha vendet e tjera të rajonit, turizmi përfaqësohet nga një Departament për Turizëm dhe një OKT / AKT.

Figura 1. Organizatat apo Agjencitë Kombëtare të Turizmit në vendet fqinje<sup>2</sup>



Sa i përket mbështetjes financiare të qeverisë për turizmin, buxheti i qeverisë për MTI-në është shumë i vogël, duke pasur parasysh se duhet të mbulojë shumë fusha dhe sektorë të tjerë brenda vetë ministrisë.

Sipas të dhënave në dispozicion, qeveria e Kosovës shpenzon më pak se 0.3% të buxhetit vjetor për të gjithë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ku turizmi përfaqësohet nga një Divizion dhe buxheti i dedikuar për sektorin e turizmit është më i ulëti në rajon. Divizioni i Turizmit (nën MTI) dhe KIESA (një Agjensi që promovon dhe mbështet investimet, eksportet, turizmin, SME-të dhe zonat e veçanta ekonomike, gjithashtu nën MTI) kanë një mbështetje shumë të ulët financiare (më pak se 100,000 euro në vit) për zhvillimin dhe promovimin e këtij sektori

<sup>2</sup> Burimi: Instituti "Demokraci për Zhvillim"

**Tabela 3. Pasqyra e financimit për turizëm në vendet rajonale <sup>3</sup>**

Shqipëria	Mali i Zi	Maqedonia	Serbia	Kroacia	Kosova
<b>13.5. Milion</b>	<b>4.3 Milion</b>	<b>2.1 Milion</b>	<b>8 Milion</b>	<b>30 Milion</b>	<b>01. Milion</b>
TVSH	TVSH	TVSH	TVSH	TVSH	TVSH
Taksa e akomodimit	Taksa e akomodimit	Taksa e akomodimit	Buxheti i drejtpërdrejt nga Qeveria	Buxheti drejtpërdrejt nga Qeveria	Buxheti i drejtpërdrejt nga Qeveria
Buxheti i drejtpërdrejt nga Qeveria	Buxheti i drejtpërdrejt nga Qeveria	Buxheti i drejtpërdrejt nga Qeveria	Donacione	Taksa e qëndrimit	Donacione
Donacione	Taksa ditore turistike	Donacione	Taksa e qëndrimit	Taksa per trashëgimi	
	Ndëshkimet		Ndëshkimet		
	Eko taksa				

Të gjitha vendet e tjera të rajonit shpenzojnë të paktën 1.3 - 1.5% dhe deri në mbi 4% të buxhetit vjetor të vendit të tyre (pra Shqipëria mbi 3.5%, Maqedonia mbi 1.5%, Mali i Zi mbi 2.5%). Jo vetëm që shpenzimet e qeverisë janë shumë të ulëta për zhvillimin e turizmit në Kosovë, por përveç kësaj, buxheti i dedikuar gjithashtu duhet të mbulojë shpenzimet e përgjithshme të MTI-së, pa ndonjë shpërndarje specifike për projektet dhe strategjitë e zhvillimit të turizmit. Nga ana tjetër, të gjitha vendet e tjera rajonale shpenzojnë buxhetin e dedikuar për turizmin në projekte specifike të zhvillimit të turizmit dhe promovimin e turizmit në nivel ndërkombëtar.

### **KAPITULLI 3: SYNIMI DHE OBJEKTIVAT**

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj qasje politike është zhvillimi i turizmit në Kosovë që do të ndikon në rritjen e përgjithshme të ekonomisë dhe rritjen e punësimit. Kjo synohet të arrihet përmes përcaktimit të organizimit ligjor – normativ të turizmit në Kosovë, me Ligjin për Turizmin dhe aktet nën ligjore, të cilat do të përcaktojnë kornizën ligjore dhe institucionale për mbështetjen e zhvillimit të turizmit konkurrues dhe të qëndrueshëm në Kosovë duke shfrytëzuar resurset

<sup>3</sup> Burimi : Po aty

natyrore, kulturore, njerëzore dhe financiare, i cili do të mundësoj krijimin e një ambienti më të favorshëm për funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarive turistike në përputhshmëri me standardet turistike bashkohore.

Objektivat specifike në hartimin e ligjit të turizmit janë:

1. **Ngritja e promovimit të turizmit të Kosovës në nivel kombëtar ( ngritja e kapaciteteve organizative institucionale përkatësisht themelimi i Agjencisë Kombëtare e Turizmit),** e cila do të kontribuon në zhvillimin e imazhit të turizmit të Kosovës si atraktiv dhe konkurrues në tregun ndërkombëtar, rritjen e numrit të vizitorëve ndërkombëtarë dhe rritja e të hyrave nga turizmi ndërkombëtar; Forcimin e rëndësisë së turizmit që të bëhet shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik në Kosovë, veçanërisht për rritjen e pjesëmarrjes së turizmit në Vlerën e Shtuar të ekonomisë së Kosovës
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve hoteliere dhe turistike në objektet akomoduese dhe ngritja e konkurrueshmërisë së tyre, përmes **klasifikimit (rangimi me yje) të detyrueshëm të objekteve akomoduese dhe monitorimit të tyre; QE DO TE KETE** Mundësimin e zhvillimit të turizmit dhe biznesit të ndërlidhur me turizmin, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike të Kosovë: rritja e numrit të hoteleve me cilësi më të lartë, rritja e numrit të hoteleve të brendeve ndërkombëtare në Kosovë, rritjen e numrit të bizneseve turistike familjare – bujtinave, turizmit bujqësorë dhe restoranteve.
3. **Licencimi/Certifikimi i operatorëve turistik/agjencive të udhëtimit (OT/AT) – duhet të jetë i detyrueshëm;** kjo i shërben mbrojtjes së konsumatorëve-turistëve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve turistike, bizneseve dhe pakove turistike.
4. Rregullimi i veprimtarisë së udhërrëfyesve turistik në Kosovë përmes **Certifikimit të ciceronëve turistik, shoqëruesve, animatorëve,** që do të mundëson rritjen e cilësisë së infomimit të turistëve, ngritjen e numrit të të punësuarve në turizëm dhe shkallës së punësimit në Kosovë.
5. **Përcaktimi i zonave turistike,** i cili do të ndikon në shfrytëzimin e duhur të resurseve natyrore dhe kulturore sipas legjislacionit perkates në fuqi dhe bashkëpunimin ndër-sektorial dhe rajonal, rritjen e investimeve turstike dhe zhvillimin e hovshëm të turizmit.
6. **Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarisë hoteliere dhe turistike,** i cili arrihet përmes definimit të kompetencave në mbikëqyrjen e veprimtarive turistike dhe hoteliere dhe përcaktimin e masave ndëshkuese nga inspektorati i tregut ne projektligjin për turizmin me qëllim të evitimit të parregullsive.
7. **Taksa turistike për akomodim ose fjetje/natë qëndrimi.** Kjo taksë krijon të ardhura për financimin e infrastrukturës dhe promovimit të turizmit dhe do të ndikoj në rritjen e buxhetit për turizëm si në nivelin qendror dhe komunal.

## KAPITULLI 4: OPSIONET

Kosova duhet të ndërmarrë ndryshime legjislative dhe institucionale në lidhje me vendosjen, organizimin dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe social, vullnetit politik dhe angazhimit-fuqisë së industrisë së turizmit që i përshtaten nevojave të vendit.

### A/ Opsioni 1: Opsioni i status quo (asnje ndryshim)

Aktualisht, sektori i turizmit nuk është vendosur si politikë prioritare e vendit dhe në këtë kontekst ka mungesë të organizimit, mbështetjes, imazhit, marketingut dhe zhvillimit të turizmit, duke marrë parasysh dhe konsideratë që sot turizmi konsiderohet si gjeneratori kryesor i rritjes ekonomike, punësimit dhe zhvillimit rajonal.

1. Në këtë opsion, nuk do të kishte promovim të organizuar të turizmit të Kosovës me ndërtim të imazhit dhe marketing aktiv për të rritur numrin e turistëve ndërkombëtarë në Kosovë. Gjendja ekzistuese poashtu do të përjashtonte apo kufizonte në mënyrë drastike dialogun e administratës publike me sektorin privat – biznesi i turizmit dhe Këshilli i Turizmit të Kosovës do të mbeteshin thjeshtë »vetëm në letër«.

Për promovim të turizmit të Kosovës aktualisht është e ngarkuar KIESA krahas promovimit të investimeve, ku në mungesë të kapaciteteve promovimi turistik organizohet pjesërisht, pa ndonjë analizë dhe pa marketing turistik. Mirëpo derisa në të gjitha shtetet e rajonit dhe Evropës dhe gati në të gjitha shtetet e botes ekziston një organizatë/agjenci kombetare e turizmit e cila ka kompetencë dhe merret ekskluzivisht me turizmin në nivel kombëtar, Kosova ende nuk ka një organizim të tillë.

Për shkak të një qasjeje të tillë pasive ndaj zhvillimit të turizmit, pozicioni konkurrues i turizmit në krahasim me vendet e tjera fqinje është i ulët, shumëllojshmëria e produkteve të turizmit, cilësia dhe atraktiviteti janë të ulëta/nën mesataren e rajonit, rrjedhimisht edhe të hyrat nga turizmi.

2. Në pesë vite pas miratimit të Ligjit për Turizmin, më pak se 15% e të gjitha hoteleve në Kosovë janë klasifikuar. Sistemi i klasifikimit të objekteve akomoduese është vullnetar dhe si i tillë vetëm 30 biznese turistike akomoduese i janë nënshtruar procesit të klasifikimit që nga viti 2014. Ky sistem nuk është sipas standardeve evropiane dhe të njëjtat kritere duhet të janë për të gjitha objektet akomoduese. Nuk ekziston një klasifikim i qartë për objektet akomoduese. Shumica e njësive akomoduese ekspozojnë yje të vetëvlersuar nga pronarët e tyre dhe kjo paraqet një mashtrim për turistët.

3. Në mungesë të rregullimit ligjor të Operatorëve Turistik vendor, Operatorët Turistik ndërkombëtar dhe ciceronët turistikë po menaxhojnë vetë turet në Kosovë nga jashtë, duke mos lënë shumë shpenzime të turistëve në Kosovë. Në mungesë të njohurive të mjaftueshme nga operatorët ndërkombëtar po krijohet një imazh i ulët i turizmit të Kosovës, gjë që ndikon në shkallën e vizitorëve në Kosovë.
4. Udhërrëfyesit turistik të Kosovës, sipas ligjit aktual nuk parashihen të jenë të certifikuar dhe licencuar nga ndonjë institucion, prandaj edhe monitorimi dhe mbikëqyrja e tyre nuk është e rregulluar me legjislacion, momentalisht ata janë duke vepruar të pa licencuar dhe pa certifikuar. Si pasojë informimi i turistëve nuk është në nivelin e duhur. Udhërrëfyesit e huaj janë duke vepruar në Kosovë sipas gjindshmërisë në treg.
5. Zonat turistike nuk janë të rregulluara me legjislacionin në fuqi. Në bazë të studimeve dhe analizave të MTI-së, është paraparë që ka potencial për shpalljen e këtyre zonave. Kjo zona do të jetë atraktive për investimet e huaja direkte.
6. Ligji aktual i turizmit nuk ka paraparë mbikëqyrjen e veprimtarisë turistike dhe nuk ka parapa masa ndëshkimore. Inspektorati i tregut mundohet ta mbulon këtë pjesë, mirëpo nuk ka rezultuar i suksesshëm pasi ka zbrazësira ligjore për tu referuar.
7. Sistemi i takses turistike për akomodim ose fjetje/natë qëndrimi nuk është funksional. Në këtë mënyrë nuk ekziston ndonjë burim shtesë i të hyrave për zhvillimin e turizmit nga qeveria apo komunat.

## **B/ Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese**

Ndryshimi sistematik dhe gjithëpërfshirës i politikave të turizmit duhet të jetë zgjidhja më e favorshme për turizmin e Kosovës që të jetë konkurrues dhe të paktën në të njëjtin nivel me vendet fqinje. Kjo qasje përfshin adoptimin e kornizës ligjore/normative për zhvillimin e turizmit në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Në vijim është dhënë përshkrimi i çështjeve kryesore që duhet të përfshihen dhe për të cilat duhet të ofrohet zgjidhje nga Ligji për Turizmin:

1. Themelimi i Agjencisë Kombëtare të Turizmit – është hapi i parë në rregullimin e turizmit, e cila duhet të sigurojë zbatimin e veprimeve të turizmit (zhvillimi, promovimi, politikat, ...) në nivelin kombëtar – horizontal, dhe atë rajonal, lokal – nivelin vertikal. Agjencia duhet të ofrojë komunikim, veprim, zbatim, informata kthyesë, vlerësim dhe reagim/modifikime<sup>4</sup>. Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) është përgjegjëse për ndërtimin dhe promovimin e imazhit turistik, veçanërisht në tregjet ndërkombëtare. Ajo themelohet si agjenci brenda

<sup>4</sup> Organizimi i turizmit në Kosovë është shtjelluar me mjaft hollësi në dokumentin: »Mbështetja për Divizionin e Turizmit në MTI«, UNDP 2015

Ministrisë përgjegjëse për turizëm dhe do të përfshinte në bordin mbikëqyrës dhe menaxhues përfaqësues të themeluesve, ministrive të linjës (që ndërlidhen me turizmin) dhe të bizneseve turistike. Statusi ligjor i Agjencisë do të jetë Agjenci, brenda MTI-së. Kjo agjenci do të ketë 7 persona të punësuar (1 udhëheqës i Agjencisë, 2 Udhëheqës të sektorëve dhe 4 zyrtarë). Ndërlidhja AKT me Departamentin e Turizmit është sepse Departamenti është përgjegjëse për hartimin e politikave turistike, ndërsa AKT do të jetë përgjegjëse për zbatimin e politikave. Departamenti do të merret me hartimin e legjislacionit për turizëm, inicimin e politikave turistike në zhvillim të turizmit në të gjitha institucionet që ndërlidhen me turizmin, caktimin e vizionit dhe strategjisë, planit të veprimit për zhvillimin e turizmit me qëllim për të përmbushur objektivat strategjike. AKT do të jetë përgjegjëse për zbatimin e politikave të hartuara nga Departamenti duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë, përkufizimin e tregjeve kryesore, aktivitetet e marketingut, si dhe ndërkombëtarizimin e turizmit kosovar. AKT-ja është agjenci që do ta realizojë këtë strategji bashkë me partnerët nga sektori publik dhe privat. Rol i veçantë i agjencisë është se do të jetë një mekanizëm koordinimi në mes të ministrive të linjës dhe institucioneve lokale si dhe sektorit privat. Përmes AKT-së Kosova do të ketë mundësinë për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare për turizëm (UNWTO, WTTC) etj. Kjo agjenci pritet të themelohet në fund të vitit 2019, ndërsa të filloj së funksionari në vitin 2020.

2. Klasifikimi i objekteve të akomodimit turistik – duke filluar me hotelet, me sistemin e yjeve, nuk ka ndonjë sistem uniform rregullativ evropian për klasifikimin e hoteleve. Nën patronatin e HOTREC – Asociacionit Evropian të Hoteleve, Restoranteve dhe Kafeneve është organizuar Hotelstar Union, e cila ka zhvilluar sistemin e klasifikimit të hoteleve që përdoret në shumicën e vendeve evropiane (me përshtatje të vogla nga secili vend). Kosova mundet që thjesht të zbatojë pjesërisht këtë sistem, t'ia përshtatë atë kushteve lokale dhe të përkufizojë periudhën e zbatimit (bashkë me periudhën e tranzicionit nga sistemi ekzistues). Propozimi për adoptimin e këtij sistemi të klasifikimit të hoteleve veç është përfshirë në dokumentin e UNDP-së të vitit 2015 që u përmend më sipër.  
Përveç klasifikimit të hoteleve, duhet të zbatohet edhe sistemi për motelet, bujtinat, kampet dhe shtëpitë fermere në turizmin rural. Sistemi i klasifikimit duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë ata që ofrojnë akomodim për turistët.
3. Licencimi/certifikimi i OT/AT – operatorëve turistikë dhe agjencive të udhëtimit – duhet të jetë i detyrueshëm; kjo i shërben mbrojtjes së konsumatorëve-turistëve dhe rritjes së cilësisë së bizneseve të pakove turistike. Kushte themelor të licencimit të OT/AT duhet të kenë oferta profesionale e pakove turistike në zyrat e hapura për publikun dhe me staf të kualifikuar, si dhe më e rëndësishmja, përgjegjësia e OT/AT-ve për turistët gjatë tureve. Për këtë qëllim, në legjislacionin kombëtar duhet të përfshihet Direktiva e BE-së duke ofruar garanci të kënaqshme për OT/AT-të në rast të insolvensës/bankrotimit të tyre – paaftësisë për të realizuar pakon turistike pjesërisht ose plotësisht. (Direktiva e BE-së 90/314/EEC dhe Direktiva e re për Paket 2015/2302/EU).



4. Licencimi/certifikimi i ciceronëve turistik – krijimi i sistemit të detyrueshëm të vlerësimit të cilësisë së ciceronëve, shoqëruesve dhe animatorëve/argëtuesve në fusha të ndryshme të aktiviteteve turistike. Ky sistem duhet të sigurojë cilësinë e shërbimeve që u ofrohen turistëve, si dhe informim të drejtë dhe përkatës dhe siguri për turistët në rend të parë. Duhet të zhvillohet sistemi i trajnimit të këtyre profileve, si dhe të zbatohet sistemi i vlerësimit në mënyrë që të kemi ciceronë të certifikuar në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe në fusha specifike të aktiviteteve turistike të përmendura më sipër.
5. Përcaktimi i zonave turistike - ku synohet rregullimi ligjor për përcaktimin e zonave turistike dhe funksionimin e tij. Përcaktohen kriteret dhe kushtet për përcaktimin e zonave turistike, definimi se kush e bënë shpalljen e tyre dhe palët e involvuara. Përcaktimi i zonave pritet të ndikon në shfrytëzimin e mirë dhe ligjor të resurseve natyrore dhe kulturore dhe bashkëpunimin ndër-sektorial dhe rajonal. Mbi të gjitha kjo do ti ndihmon sektorit privat për zhvillimin e produkteve turistike dhe investimet në turizëm dhe sektorin e akomodimit.
6. Mbikëqyrja e tregut- i cili arrihet përmes definimit të kompetencave në mbikëqyrjen e veprimtarive turistike dhe hoteliere dhe përcaktimin e masave ndëshkuese nga inspektorati i tregut në projektligjin për turizmin me qëllim të evitimit të parregullsive.
7. Taksa turistike për akomodim ose fjetje/natë qëndrimi. Ligji mbi Turizmin duhet të përshkruajë dhe parasheh një sistem të burimeve financiare që mundëson financimin në ndërhyrjet për turizëm. Në të gjitha vendet turistike ekziston një burim i veçantë financiar për turizmin - taksa turistike për akomodim ose fjetje/natë qëndrimi. Kjo është një e ardhur për financimin e infrastrukturës dhe promovimit të turizmit që mblidhet në shumë fikse dhe caktohet në çmimin për akomodimin për një natë dhe paguhet nga turistët për çdo natë të kaluar në objektet e akomodimit. Taksa turistike për akomodim për një natë dallon për lloje të ndryshme të objekteve të akomodimit dhe sipas llojit të turistëve (si hotelet, fermat turistike, kampet dhe studentët ose nxënësit, turistët me aftësi të kufizuara etj). Kjo taksë do të mblidhet nga komunat për strukturat akomoduese në rajonin e tyre dhe një përqindje e caktuar sipas ligjit të turizmit, do të mbetet në buxhetin e komunave për tu shfrytëzuar në zhvillim të turizmit dhe pjesa tjetër do të buxhetohet në buxhetin e shtetit. (P.sh 60% në buxhetin e komunës dhe 40% në buxhetin e shtetit). Kjo e hyrë në buxhetin e shtetit do të jetë një burim i financiar që do të ndikon në rritjen e buxhetit të ndarë nga qeveria për funksionimin e OKT-së

### **C/ Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit**

Ky opsion duhet të shoqërohet me ndarjen e buxhetit të konsiderueshëm për Departamentit të Turizmit në dhe aktivitete shtesë dhe shtimin e punëtorëve. Kjo do të bëhet kryesisht përmes masave që mbështesin NVM-të, ndërkohë që nuk do të kishte fuqizim shtesë për të trajtuar

çështjet strategjike të zhvillimit të turizmit. Në këtë rast, Departamenti i Turizmit do të ishte në gjendje të zhvillonte bashkëpunim më të ngushtë me njësitë administrative lokale të turizmit në komuna, që do të përmirësonin transmetimin e veprimeve të politikave nga niveli më i lartë në atë lokal, ndërkohë që në anën tjetër iniciativat dhe/ose problemet e turizmit do të mund të procedoheshin në mënyrë më të drejtpërdrejtë në nivel kombëtar. Departamenti i Turizmit në këtë rast do të mund të përmirësonte gjithashtu shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet ministrive në çështjet që ndërlidhen me turizmin.

Sipas opsionit të tretë besimi në Operatoret Turistik dhe Agjencite Turistike në Kosovë do të ishte i ulët nëse nuk janë të licencuara dhe cilësia e shërbimeve të tyre do të jetë diskutabile për udhëtarët individual dhe gjithashtu për OT/AT ndërkombëtare që kërkojnë partnerë për të ushtruar biznesin e turizmit lokal në destinacione të ndryshme. Do të kishte gjithashtu një liri për organizimin e ciceronëve/guidave turistike me cilësi, besueshmëri dhe siguri të dyshimtë (nëse marrim parasysh gjithashtu guidat malore dhe avanturistike në parqet natyrore).

Biznesi i turizmit do të zhvillohej në bazë të iniciativave sipërmarrëse, standardet e cilësisë dhe përmirësimi dhe kujdesi për konsumatorët/turistët do të menaxhoheshin nga shoqatat e turizmit që do të themeloheshin me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare të donatorëve ose do të krijoheshin si pasojë e nevojave dhe kërkesave të biznesit të turizmit.

Kjo qasje zakonisht është më efiçase në vendet tjera me një traditë të gjatë të turizmit dhe nivel të lartë besimi në rregullimin jo-formal.

Promovimi dhe marketingu i turizmit të Kosovës në tregjet ndërkombëtare përsëri nuk do të udhëhiqej nga synimet e kjarra strategjike dhe pa analizë të tregut. Koordinimi i aktiviteteve promovuese do të ishte sfidues dhe si pasojë Kosova nuk do të mund të konkurroj me vendet tjera si destinacion turistik.

## KAPITULLI 5: PËRMBLEDHJE E OPSIONEVE

Përmbledhja e 3 opsioneve të përshkruara në kapitullin më lart sipas karakteristikave kryesore është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 4: Përmbledhje e opsioneve**

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Status quo; Vazhdimi i situatës aktuale	Ndryshimi sistematik dhe kompleks/gjithëpërfshirës i politikës së turizmit	Qasje e pjesshme/e përzgjedhur për të ndryshuar politikën e turizmit
Popullsia e synuar	Objektet/Ndërmarrjet	Objektet/Ndërmarrjet e	Objektet/Ndërmarrjet

/sektorët/rajonet që do të ndikohen	e akomodimit, OT/AT, Ciceronët; rajonet e zhvilluara turistike	akomodimit, OT/AT, Ciceronët; rajonet e zhvilluara turistike	e akomodimit, OT/AT, Ciceronët; rajonet e zhvilluara turistike
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - qeveria (kush), sektori privat, qytetarët	Divizioni i Turizmit në MTI ka përgjegjësi të kufizuar; iniciativa dhe përgjegjësia kryesore bie mbibizneset e turizmit-sektori privat	Qeveria - MTI me Departamentin e Turizmit ka përgjegjësinë madhore; përgjegjësi të vogël-tëkufizuar kanë shoqatat e biznesit të turizmit - sektori privat	Përgjegjësia kryesore bie mbi shoqatat e biznesit të turizmit - sektori privat
Administrimi ose ofrimi i shërbimit ose programit	Asnjë program gjithëpërfshirës, ndërsa iniciativa dhe detyra të pjeshme	Sistemi i qëndrueshëm i turizmit me zgjidhje ligjore dhe platformë për Dialogun Publiko Privat	Programe për shoqatata dhe bizneset të turizmit
Ligji, legjislacioni sekondar, ndryshimet, zbatimi, ndëshkimet	Legjislacioni ekzistues jo i zbatuar	Ligji gjithëpërfshirës për Turizmin dhe një sërë Udhëzimesh Administrative	Disa ndryshime jo të mjaftueshme mbi zbatimin e Ligjit ekzistues mbi Turizmin
Incentivat ose dekurajimet ekonomike - taksat ose subvencionet	Praktikisht asnjë	Incentiva dhe subvencione të konsiderueshme; taksa e re për bujtjet/fjetjet turistike dhe rritja e financimit të turizmit nga buxheti i shtetit	Incentiva të kufizuara-të vogla, nuk ka taksa të reja dhe rritje të vogël të financimit të turizmit nga buxheti i shtetit
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Jo ose shumë pak fushata komunikimi	Fushata sistematike të komunikimit	Disa fushata të komunikimit me programe arsimore për ofruesit e turizmit
Udhëzimet dhe kodet			
Koha - kur do të hyjë në fuqi opsioni	Opsioni i vazhdimit të gjendjes ekzistuese	Në 2-3 vite deri në zbatim të plotë	Në më shumë se 7 vite deri në nivel të arsyeshëm të implementimit

## KAPITULLI 6: ANALIZA E OPSIONEVE

Një vlerësim i të 3 opsioneve me analizën e përfitimeve dhe pasojave negative për secilin rast na jep pasqyrën përmbljedhëse si në vijim:

### 1. Lista e përfitimeve të opsionit 1:

Ekzistojnë shumë pak përfitime nëse vazhdon gjendja aktuale, por mund t'i përmendim këto dy përfitime:

- a. Mundësi të mëdha dhe pothuajse të pakufizuara për iniciativat private në zhvillimin e biznesit dhe organizatat/shoqatat e biznesit, megjithëse ekziston dyshimi nëse do të kishte shumë investime në biznesin e turizmit nëse kushtet dhe rregullat nuk janë të qarta.
- b. Mundësi të mëdha për të mbështetur zhvillimin e turizmit dhe biznesin e turizmit nga institucionet arsimore dhe kërkimore

### 2. Lista e përfitimeve të opsionit 2:

Ky opsion parasheh mjedis gjithëpërfshirës ligjor dhe organizativ të turizmit në Kosovë. Do të ketë shumë përfitime nga zbatimi i këtij opsioni:

- a) Turizmi do të fitojë një organ përfaqësues, të aftë dhe të fortë administrativ dhe agjenci promociionale për caktimin e planeve strategjike, politikave dhe aktiviteteve të marketingut të turizmit që do të formojnë një mjedis pozitiv për zhvillimin e biznesit të turizmit dhe marketingut –duke tërhequr turistët ndërkombëtarë
- b) Biznesi i turizmit do të fitojë standarde ndërkombëtarisht të krahasueshme për hapjen dhe zhvillimin e objekteve/ndërmarrjeve të akomodimit turistik
- c) Turistët do të kenë ofrues dhe agjenci të besueshme turistike me siguri për cilësinë dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit
- d) Biznesi i turizmit do të rrisë cilësinë e produkteve dhe shërbimeve dhe rrjedhimisht do të rrisë të hyrat nga biznesi i turizmit
- e) Kosova do të bëhet më tërheqëse për investimet e huaja në turizëm
- f) Kosova gjithashtu do të bëhet më tërheqëse për turistët ndërkombëtarë për shkak të ndërtimit të imazhit, marketingut dhe promovimit aktiv
- g) Do të rritet atmosfera e investimeve dhe biznesit të turizmit
- h) Do të ketë gjithashtu bashkëpunim më intensiv dhe efikas me organizatat ndërkombëtare të turizmit

Të gjitha këto rezultate do të kontribuojnë në arritjen e objektivit të përgjithshëm, që të ketë turizëm të fortë si sektor ekonomik që do të kontribuojë në BPV dhe Vlerën e Shtuar të Kosovës dhe do të kontribuojë në imazhin e vendit dhe turistë më të kënaqur.

Të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e sipërme do të regjistrohen në raportet e MTT-së, Departamentit të Turizmit dhe nga AKT - Agjencia Kombëtare e Turizmit. Të gjitha rezultatet e tjera do të regjistrohen statistikisht, nga më shumë ardhje dhe bujtje/fjetjetë turistëve, më shumë të hyra nga turizmi ndërkombëtar, më shumë objekte/ndërmarrje afariste të turizmit.

Përfitimet indirekte do të jenë:

- Strategji më e qartë e zhvillimit dhe marketingut të turizmit dhe plani i veprimit, politika më efikase e turizmit dhe më shumë mbështetje për biznesin e turizmit dhe palët e tjera të interesit
- Rritja e atmosferës së investimeve dhe biznesit të turizmit
- Kënaqësi më të madhe të akterëve të turizmit që zhvillojnë produkte dhe shërbime turistike strategjike dhe cilësore
- Rritja e interesimit të gjeneratës së re për të studiuar dhe kërkuar punë në turizëm
- Rritja e krenarisë së banorëve dhe diasporës rreth Kosovës dhe atraksioneve të Kosovës - natyrore, kulturore, gastronomike, ngjarjeve dhe të ngjashme.

### **3. Lista e përfitimeve të Opsionit 3**

Përfitimet e këtij opsioni janë:

- a) Mbështetje më e fortë për biznesin e turizmit dhe shoqatave të tyre
- b) Forcimi i fuqisë dhe ndikimit të ndërmarrjeve afariste të turizmit dhe sidomos të shoqatave të tyre
- c) Bashkëpunimi i ngadalhtë dhe i kujdesshëm me partnerët ndërkombëtarë të biznesit
- d) Rritja e ngadalhtë e ardhjeve turistike dhe të hyrave nga turizmi

Standardet dhe normat e tjera do të hyjnë ngadalë në turizmin e Kosovës në varësi të forcës së bizneseve të turizmit dhe sidomos të shoqatave të tyre.

Krahas përfitimeve nga 3 opsionet për të mbështetur turizmin e Kosovës me organizimin ligjor, ka edhe pasoja negative kur adaptohen secili prej 3 opsioneve.

#### **a) Lista e pasojave negative të Opsionit 1:**

Në opsionin e Status quo mund të presim pasojat më negative sepse praktikisht nuk do të ketë ndryshime në organizimin ligjor të turizmit në Kosovë:

- Kompetencë jo e mjaftueshme e Divizionit të Turizmit në administratën shtetërore dhe në lidhje me biznesin e turizmit
- Buxheti i ulët që nuk lejon ndonjë projektim dhe zbatim të politikës së turizmit
- Nuk ka zhvillim të turizmit dhe strategji marketingu dhe zhvillim të një brendi turistik të Kosovës

- Nuk ka futje të standardeve dhe normave ndërkombëtare- të BE-së në operacionet e turizmit (licencat për OT / AT, licencat ose certifikatat për ciceronët turistikë, klasifikimet e objekteve/ndërmarrjeve të akomodimit etj.)
- Sipas Direktivës Evropiane të shërbimeve, vetëm 2 shërbime turistike në Kosovë janë të mbuluara pjesërisht me legjislacion, ndërsa gjatë fazës së evidentimit të shërbimeve në Kosovë, nga projekti i BE-së i realizuar në MTI për Adaptimin e Direktivës u evidentuan se ekzistojnë gjithsej rreth 24 shërbime turistike që operojnë në Kosovë pa ndonjë kriter dhe rregullim ligjor.
- Cilësia e ulët e produkteve dhe shërbimeve turistike dhe pozita e tyre e dobët konkurruese në treg
